

Tirana, 28.06.2021

**Albana VOKSHI**  
**Deputete e zgjedhur,**  
**Ish Kryetare e Komisionit Parlamentar për Cështjet e Medias**  
**Bulevardi "Zhan D'Ark", no. 11**  
**1001 Tirana**  
**Albania**

**PËR:**            **Delegacioni i BE-së në Shqipëri**  
**Prezenca e OSBE-së në Shqipëri**  
**Zyra e Këshillit të Europës në Shqipëri**  
**Ambasada Amerikane në Shqipëri**  
**Ambasada e Austrisë**  
**Ambasada e Bullgarisë**  
**Ambasada e Republikës Çeke**  
**Ambasada e Danimarkës**  
**Ambasada e Francës**  
**Ambasada e Gjermanisë**  
**Ambasada e Greqisë**  
**Ambasada e Hollandës**  
**Ambasada e Hungarisë**  
**Ambasada e Italisë**  
**Ambasada e Kroacisë**  
**Ambasada e Maltës**  
**Ambasada e Polonisë**  
**Ambasada e Rumanisë**  
**Ambasada e Sllovakisë**  
**Ambasada e Sllovenisë**  
**Ambasada e Spanjës**  
**Ambasada e Suedisë**

**NGA:**            **Albana VOKSHI**

**LËNDA:**        **Disa shqetësime në lidhje me kërcënimin e lirisë së medias në Shqipëri**

---

I / E nderuar,

Në vijim të informacioneve që ju kemi dërguar në lidhje me situatën e lirisë së medias në Shqipëri, përmes kësaj letre dëshirojmë t'ju vëmë në dijeni e të shprehim shqetësimin e madh për disa zhvillime të fundit që rrezikojnë të çenojnë lirinë dhe pavarësinë e mediave dhe të autoriteteve publike që i kontrollojnë ato.

***1. PËRJASHTIMI I GAZETARËVE TË AKREDITUAR NGA AKSESI NË KOMISIONET PARLAMENTARE***

Më datë 2 qershor 2021, Byroja e Kuvendit të Shqipërisë ka marrë një vendim për të përjashtuar gazetarët e akredituar nga aksesi në komisionet parlamentare. Vendimi I Byrosë së Kuvendit

ndalon raportimin e pavarur të gazetarëve dhe e zëvendëson atë me transmetime zyrtare të kontrolluara.

Në dt 6 qershor 2021, reagoi PD e cila e konsideroi këtë vendim antidemokratik, me anë të të cilit media ndalohet të marrë pjesë në komisionet parlamentare (aty ku diskutohen ligjet), ndalohet të pyesë deputetët, ndalohet të jetë aty ku ngjarja ndodh. Në vend të informimit të plotë të publikut, gazetarët urdhërohen të komunikojnë me publikun vetëm përmes pamjeve të regjisë së centralizuar të kuvendit. Vendimi është antidemokratik, antikushtetues, i detyron gazetarët të qendrojnë të izoluar në një dhomë, të rrethuar nga Garda e pushtetit. Vendimi, i pari i këtij dimensionit pas 30 vitesh parlamentarizëm, është marrë në mungesë të plotë transparence. Ai nuk është konsultuar me shoqatat dhe grupet e gazetarëve dhe është, në shkelje të të drejtave Kushtetuese për informim, kuadrit ligjor, konventave ndërkombëtare si dhe vetë frymës së transparencës dhe hapjes me mediat që përcjell ndër vite Rregullorja e Kuvendit. Kuvendi I Shqipërisë kthehet kështu në një tjetër institucion të mbyllur për mediat.

Në dt 9 qershor, gazetarët që raportojnë nga Kuvendi i Shqipërisë, por jo vetëm, zhvilluan një protestë simbolike para nisjes së seancës plenare. Ata e cilësuan vendimin “cënim të pastër të punës së tyre dhe lirisë së medias” si dhe nënshkruan një peticion ku i kërkuan Kuvendit të tërhiqet nga vendimi dhe ti bëjë ata pjesë të diskutimeve për rregulloren e re. Përveç gazetarëve, vendimi u kritikua nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Instituti i Studimeve Politike.

Në dt 10 qershor 2021, Delegacioni I BE në Tiranë me anë të një statusi në twitter shprehet “Dëgjuesat publike dhe qasja e mediave në PArlament për të mbuluar punën e seancave dhe komisioneve të tij janë elemente të rëndësishme të një demokracie liberale. Keqardhje për mungesën e konsultimeve me mediat përpara miratimit të rregullave të reja nga PArlamenti. Këto rregulla nuk janë në përgjigje të Udhëzimeve të BE ose këshillave të dhëna nën ndihmën e IPAs të nisura në këtë kontekst në vitin 2014

PD ka kërkuar që të tërhiqet sa më parë kjo nismë që censuron punën e gazetarëve dhe cënon të drejtën kushtetuese të qytetarëve për informim.

## **2. KAPJA E KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH**

Në bazë të ligjit nr. 97/2013, Këshilli Drejtues i RTSH përbëhet nga Kryetari dhe 10 anëtarë. Duhet theksuar, se për shkak të rëndësisë së madhe që ka ky Këshill, mes opozitës dhe qeverisjes ishte krijuar një traditë disa vjeçare e cila konsistonte në balancimin e faktorëve dhe mbështetjen e faktin që shumica parlamentare të kishte të drejtën të mbështeste miratimin e zgjedhjes së shumicës së anëtarëve në këtë Këshill, ndërsa opozita do të gëzonte të njëjtën të drejtë për të mbështetur katër kandidatë.

Si pasojë e përfundimit të mandatit të tre anëtarëve, të zgjedhur me vendimet nr. 101, dt. 04.12.2014, nr. 56, dt. 30.04.2015, nr. 57, dt. 30.04.2015 të Kuvendit, në Këshillin Drejtues të RTSH u krijuan tre vakanca. Më konkretisht: Z. Pashk Përvathi dhe Z. Artan Peqini, gëzonin mbështetjen e Partisë Demokratike, ndërsa kandidati tjetër Z. Helidon Haliti gëzonte mbështetjen e shumicës socialiste.

Në zbatim të procedurave ligjore, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ftoi subjektet e parashikuara në ligj për të paraqitur kandidaturat e tyre. Në përfundim të të gjithë procedurave, Komisioni, më datë 04.02.2019, vendosi miratimin e tre kandidatëve për anëtarë të KDRTSH që ishin: z. Besnik Mustafaj dhe z. Edmond Tullumani që u mbështetën nga PD, dhe z. Heldon Halili që u mbështet nga PS.

Kuvendi I Shqipërisë vonoi qëllimshëm për 2 vjet kandidaturat e miratuara në unanimitet të plotë, në respekt të ligjit, në Komisionin e Medias.

Në datë 28.01.2021, në një akt të paprecedent në historinë e parlamentarizmit kandidaturat e miratuara në unanimitet në komisionin parlamentar, u rrëzuan nga seanca plenare.

Me shpejtësi, pa transparencë, pa konsultime, në muajin shkurt Kuvendi miraton tre anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH: z. Petrit Ruka, z. Mevlan Shanaj dhe znj. Ardita Recu ndërkohë që në dt 7 maj 2021 miratoi edhe katër kandidaturat e tjera përkatësisht: znj. Milena Selimi, z. Thanas Goga, z. Gëzim Podgorica dhe z. Engjëll Ndocaj. Është me rëndësi të mbahet në konsideratë fakti që këto vendime u morën pa opozitë reale pasi deputetët që votuan, në zgjedhjet e fundit parlamentare ishin në listën e kandidatëve të Partisë Socialiste.

Për herë të parë në 30 vite pluralizëm Këshilli Drejtues RTSH është I tëri I përzgjedhur nga partia në pushtet. Kjo vendimmarrje rrezikon që ta kthejë transmetuesin publik në transmetues shtetëror në shërbim të qeverisë duke cënuar pavarësinë e radiotelevizionit të vetëm publik në Shqipëri.

### *3. KAPJA E AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE*

Në ditët e fundit të mandatit, parlamenti, ka vendosur të hapë me nxitim garën për emërimin e anëtarëve të Bordit të AMAs përfshirë edhe ata që i përkasin opozitës. Në shkelje të ligjit, nga 30 ditë për paraqitjen e aplikimeve për Kreun e AMAs, janë lënë në dispozicion vetëm 20 ditë, që tregojnë qartë për një vendim të paracaktuar. Vendimi për të emëruar në mungesë transparence, me nxitim, ditët e fundit të këtij parlamenti, është i paligjshëm, dhe shkon ndesh me rekomandimet e Komisionit të Venecias duke përkeqësuar imazhin e Shqipërisë si një vend jodemokratik, ku liria e medias është në rrezik.

Disa muaj më parë, Komisioni i Venecias rekomandoi në mënyrë të qartë se “përbërja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Audiovizive apo Komisionit të Ankesave duhet të sigurojë autonominë e tyre nga kontrolli i qeverisë dhe i korporatave”. Ky rekomandim po shkelet hapur nga maxhoranca, duke shkuar drejt kapjes totale të të gjithë institucioneve që kanë lidhje me median. Vendosja nën kontroll të plotë i Autoritetit të Mediave Audiovizive, kufizon lirinë dhe pavarësinë e medias, instalon një regjim censure, shkel të drejtat e njeriut dhe rrezikon demokracinë në Shqipëri.

Duhet të qartësojmë se Autoriteti i Mediave Audiovizive ka për detyrë garantimin e konkurrencës së ndershme, hartimin e strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve, monitorimin e programeve të transmetuara, hartimin dhe miratimin e rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, gjithashtu ajo ka për detyrë edhe zbatimin e ligjit për

median dhe në rast se konstaton shkelje nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive, ajo vendos sanksione.

Në datën 23/06/2021 në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar projekt-vendimi për zgjedhjen e Kryetarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, ndërsa zgjedhja e Kryetarit do të bëhet në seancë plenare më datë 01/07/2021. Gjasat janë që në krye të këtij autoriteti që duhet të jetë ligjërishit i pavarur, të zgjidhet znj. Armela Krasniqi, ish-zëdhënëse e Partisë Socialiste, Kryeministrisë dhe aktualisht drejton Agjencinë Telegrafike Shqiptare. Neni 7 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se individët që janë anëtarë të politike apo shoqatave politike nuk mund të jenë anëtarë të AMA-s.

Ligji parashikon që mazhoranca të propozojë 4 kandidatura për kryetarin e AMA-s dhe për të shmangur emërimin e personave thellësisht politikë në drejtim të institucionit, i jepet mundësia opozitës të eliminojë dy prej kandidaturave. Dy të tjerat vazhdojnë më garën dhe votohen në parlament. Duke qenë se në Parlament mungon opozita reale, mazhoranca aktuale po nxiton që të mbyllë që tani procedurën me praninë e deputetëve pseudo opozitarë që në zgjedhjet e fundit kanë qënë në listat e kandidatëve të PS. Pritet që në seancën e radhës ajo të votohet në parlament.

Sipas paketës “anti-shpifje” të përgatitur nga mazhoranca, Autoriteti i Mediave Audiovizuale mund të shndërrohet në kontrollues dhe censurues të medias e në vecanti asaj on line pasi AMA ka të drejtë të verë gjoba të rënda ndaj portaleve dhe televizioneve që sipas AMA-s kanë gabuar. Madje gjobat e AMA-s, që do të rëndojnë në veçanti portalet, do të ekzekutohen para vendimit të gjykatës, sipas ligjit të ri. Kjo pikë, është kundërshtuar ashpër nga gazetarët, por edhe nga Komisioni i Venecias.

Komisioni i Venecias, ka ngritur shqetësimin që institucionit të AMA-s i janë dhënë fuqi të mëdha administrative përballë mediave online. “Këto fuqi të reja nuk duhet t’u besohen institucioneve të tilla pa u siguruar më parë nëse janë të pavarura nga partitë politike, bizneset e mëdha të mediave, ose interesat e korporatave të lidhura me politikën”– shprehej Komisioni i Venecias.

Komisioni i Venecias vijon më tej: “Do të ishte e dobishme edhe të rishikohet metoda e zgjedhjes së anëtarëve të AMA-s për t’u siguruar që këto institucione kanë një përbërje pluraliste, me individë të kualifikuar, përfaqësues të bashkësisë së medias, dhe që gëzojnë një autonomi të besueshme prej qeverisë dhe kontrollit të korporatave”.

Komisioni i Venecias, thekson me shqetësim faktin që draft ligji rrit rreptësinë e masave ndëshkuese dhe mund të nxisë auto-censurën tek gazetarët. Zbatimi i këtyre rekomandimeve ishte një kërkesë së fundmi edhe e parlamentit hollandez që pranoi të mbështeste hapjen e negociatave për Shqipërinë.

Në këto kushte, emërimi i ish zëdhënëses së Partisë Socialiste në krye të AMA-s do të cënonte rëndë pavarësinë e medias dhe lirinë e shprehjes, duke e kthyer AMA-n në shërbim të pushtetit.

#### **4. PAKETA “ANTI-SHPIFJE”**

Megjithë rekomandimet e qarta të Komisionit të Venezas dhe thirrjeve nga BE për tërheqjen e paketës “Anti-shpifje”, Qeveria e Kryeministrit Rama duket e vendosur të mos bëjë asnjë hap pas.

Pas rekomandimit zyrtar të Venezas, edhe Komisioni European ka reaguar mbi shqetësimet që ngre kjo paketë dhe rrëzimin e saj nga presidenti i Republikës, Ilir Meta.

“Ne e kemi bërë të qartë se Bashkimi European mbështet rekomandimet e Këshillit të Europës në rastin e ligjit të medias në Shqipëri. Ne pranojmë se shqetësimet dhe rekomandimet përkatëse janë sërish të vlefshme dhe ato duhen adresuar sërish. Faktin që Presidenti i Shqipërisë ka kthyer ligjin në Parlament e shohim si një mundësi për t'i pranuar ato. Ne shpresojmë që kjo të realizohet”. “Ne mbështesim disa rekomandime të Këshillit të Europës jo vetëm për promovimin e vetëregullimit. Por ne e mbështesim qëllimin për ta kufizuar rregullimin vetëm për shërbimet e mediave audiovizive online, trajtimin gjyqësor të pavarur të ankesave lidhur me mediat, forcimin për transparencën e pronësisë së mediave në vend. Pra, ne mbështesim të gjitha rekomandimet e Këshillit të Europës. Ato janë në përputhje me pritshmërinë tonë, që duhet ndjekur nga një vend aspirant” - deklaroi zëdhënësja e KE-së, Ana Pisonero.

Përkundër kësaj, Kuvendi aktual, prej një viti e ka miratuar dhe nuk e ka tërhequr paketën antikushtetuese “Antishpifje”, në refuzim të hapur të rekomandimeve të Komisionit të Venezas dhe Komisionit European.

Pa fjalë të lirë, nuk mund të ketë votë të lirë, nuk ekziston as shoqëria e lirë. Në këtë drejtim, vendi ynë vazhdon të bëjë hapa mbrapa me ritme alarmante. Shqipëria, sipas Raportit të Freedom House<sup>1</sup> për vitin 2020 ka humbur pikë përse i takon të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias. Shqipëria konsiderohet një shtet që ka një situatë të vazhdueshme problematike, që nuk ka bërë progres lidhur me lirinë e medias. Sipas Indeksit të Lirisë së Medias të “Reporterëve pa Kufij”<sup>2</sup>, Shqipëria ka humbu 7 pikë 2 vitet e fundit dhe renditet në vendin e 83 në botë nga 180 vende.

Në këto kushte, kërkojmë mbështetjen tuaj në nevojën urgjente për të ushtruar cdo influencë mbi Qeverinë Shqiptare për të ndaluar cdo veprim që cënon lirinë e fjalës, lirinë e medias dhe të drejtën kushtetuese për informim.

ALBANA VOKSHI



<sup>1</sup> <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021>

<sup>2</sup> <https://rsf.org/en/albania>